1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë private)

Faqe 35

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga znj. Sherameti

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni, Znj. Sheremeti.

16 ZNJ. SHEREMETI: [Përkthim]

17 PY. Të vazhdojmë më tej. Në përmbledhje të raportit të
18 prillit të 2025, ju shkruani shprehimisht dhe këtu do lexoj,
19 do citoj:

20 "Për t'i dhënë kuptim këtyre konstatimeve do të duhen
21 parë kontekstet: simptomat psikologjike që janë treguar nga
22 viktimat në dëshminë në një kuadër ligjor."

23 Duke qenë që ju përmendni kontekstin, nuk e di a keni
24 vlerësuar kontekstin më të përgjithshëm faktin se ku kanë
25 jetuar këta persona ose faktin që ata kanë qenë pjesë e

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 36

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga znj. Sherameti

1 luftës, kanë marrë pjesë në luftë, domethënë, i keni marrë
2 këto elementë të kontekstit parasysh dhe a i keni interpretuar
3 ato në raportin tuaj?

4 Duhet të caktoj unë, domethënë, se kush duhet të
5 përgjigjet? Apo mund t'i përgjigjet secila prej jush,
6 Dëshmitare.

7 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Catherine Black. Më herët
8 sot paradite, mendoj se e përmenda se çfarë kemi konsideruar
9 ne është që mjedisi nuk është projektuar, domethënë, me fjalë
10 të tjera, nuk bëhet fjalë për një intervistë sa i takon
11 simptomave të tyre psikologjike, sigurisht që ka shumë faktorë
12 të tjerë të cilët mund të luajnë rolin e tyre dhe të
13 përcaktojnë se çfarë është raportuar apo çfarë nuk është
14 raportuar. Po gjithashtu edhe sjellja e personit ose sa
15 empatik ishte personi që ishte objekt i intervistimit.
16 Domethënë, ka shumë faktorë.

17 Megjithatë, mbështetur në përvojën tonë profesionale,
18 përvojën klinike por gjithashtu edhe udhëzimet e Konventës së
19 Stambollit, mendojmë që ka më shumë gjasa që të kemi të bëjmë
20 me nënraportim të simptomave në atë mjedis, në atë ambient
21 sepse ne e dimë nga përvoja se nga një mori arsyesh njerëzit
22 shmangin realitetin, domethënë, nuk thonë të vërtetën dhe kanë
23 tendencën që të mos i thonë të gjitha simptomat e tyre.

24 PY. Në rregull. Znj. Prinsen, doni të shtoni diçka?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Mendoj që pyetja

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 37

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga znj. Sherameti

1 jua j ka të bëjë me faktin në qoftë se kemi konsideruar ose
2 kemi marrë parasysh kontekstin më të gjerë jo vetëm kontekstin
3 në të cilin janë bërë pyetjet, domethënë, kontekstin nga cilët
4 vijjnë viktimat. Mendoj që kjo është jashtë fushës së punës
5 tonë, domethënë, kjo nuk ishte pjesë e punës tonë. Ne kemi
6 identifikuar thjesht simptoma psikologjike.

7 Dhe sikurse e thashë dhe pak më herët, ne nuk komentojmë
8 dot se nga janë ata e të tjera.

9 PY. E kuptoj. Domethënë, juve thjesht bëtë punën që ju kërkua
10 që të bënit, apo jo? Në rregull. Do kalojmë tani tek pyetja
11 ime e fundit, do kalojmë tani tek faqen 15 të të njëjtit
12 raport. Në këtë faqe ju thoni që:

13 "... simptomat dhe pasojat psikologjike janë koduar
14 mbështetur në deklaratat e dhënë gojarisht nga viktimat gjatë
15 procesin ligjor. Konstatimet nuk mbështeten në ekzaminimet
16 mjeko-ligjore të kryera nga një psikolog."

17 Më tej ju thoni që:

18 "... nuk janë bërë deklarata lidhur me kushtet mjekësore
19 ose vlefshmërinë e simptomave."

20 Ndërkohë, dje, gjatë pyetjeve të Mbrojtësit të Viktimave
21 dhe të palëve të tjera, ju thatë që konfirmoni që simptomat e
22 shprehura nuk përshkruajnë ose nuk konfirmojnë simptomat e
23 përshkruara dhe që reflektojnë një çrregullim të njohur
24 psikologjik. Tani pyetja që kam për juve është kjo: Si duhet
25 t'i kuptojë Trupi Gjykses përfundimet tua? Ose si duhet t'i

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 38

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga znj. Sherameti

1 kuptojmë ne palët dhe Trupi Gjykses në veçanti këto konstatime
2 tua, a mund t'i shtjelloni pak më tej, mund të na sqaroni
3 pak më tej?

4 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Catherine Black. Ju kërkoj
5 ndjesë në qoftë se po përsëris veten, megjithatë dëshiroj të
6 them që kemi parë kampionin e viktimave dhe konstatuar,
7 sikurse e kemi përshkruar, që raportohen prej tyre simptomat
8 të cilat njihen gjerësisht dhe shprehimisht nga literatura
9 përkatëse. E thashë dhe më herët, që nuk është befasues si
10 konstatim për ne. Mendoj që ne ishim, ose unë personalisht të
11 paktën isha paksa e befasuar ose e çuditur nga fakti që këto
12 janë simptomat të cilët kanë dalë shumë qartë nga intervista
13 në fakt që nuk kishin si detyrë kryesore që të identifikonin
14 këto simptoma.

15 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Mendoj që nuk kemi
16 asgjë për të thënë, thjesht do përsërisim veten.
17 PY. Domethënë, është thjesht një vlerësim i përgjithshëm,
18 kështu?

19 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po. Dhe sikurse e
20 thashë edhe më herët, nga perspektiva mjekësore, kjo ka vlerë.
21 Mënyra sesi janë përmendur simptomat nga viktimat në një
22 proces ligjor, vlerën duhet t'ia jepni juve në procesin
23 ligjor, ne thjesht po flasim për aspektin mjekësor.
24 PY. Faleminderit. Faleminderit të dyjave, znj. Prinsen dhe
25 Dr. Black.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 39

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 ZNJ. SHEREMETI: [Përkthim] Faleminderit shumë edhe Trupit
2 Gjykues.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
4 ju, znj. Sheremeti.

5 Tani vazhdojmë me Mbrojtjen e z. Krasniqi. Z. Baiesu, për
6 ju fjala.

7 Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu:

8 Z. BAIESU: [Përkthim]

9 PY. Faleminderit, znj. Prinsen. Unë jam Victor Baiesu dhe do
10 t'ju bëj disa pyetje në emër të Jakup Krasniqit.

11 Znj. Prinsen, në raportin tuaj përmendet disa herë fakti
12 që ka pasur nënraportim të simptomave, a është e saktë kjo?

13 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Për cilin raport e
14 keni fjalën?

15 PY. E kam fjalën për raportin e prillit të 2025-s. Domethënë,
16 në këtë raport ju përmendni disa herë që ka faktorë që kanë
17 kontribuar nënraportim të simptomave?

18 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

19 PY. Në rregull. Do t'ju jap disa shembuj në të cilat ju keni
20 pasqyruar këtë si fenomen, për shembull, jepet në provën
21 materiale V35, në faqen V12, V20, V21 e kështu me radhë.

22 Dje, ju, znj. Prinsen - dhe për procesverbal këtë e keni
23 thënë dje në transkript në faqen T26234, rreshti 34, deri në
24 faqen 26233, rreshti 10 - ku ju thoni që përdorni në mënyrë të
25 zakonshme Protokollin e Stambollit në mënyrë të tillë që të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 40

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 kryeni ekzaminime mjekësore, psikologjike, ligjore dhe
2 gjithashtu dhe për të dalë në konstatimet tuaja në akt-
3 ekspertizat ose në raportet përkatëse, a është e saktë kjo?

4 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

5 Z. BAIESU: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të paraqesë
6 në ekran dokumentin DJK01479 deri në DJK01703 në faqen
7 DJK01580. Kalojmë pak më poshtë në paragrafin 348.

8 PY. Do t'ju lexoj një fragment nga paragrafi 348 i
9 Protokollit të Stambollit. Në të thuhet:

10 "Është e rëndësishme të pranohet që disa njerëz në mënyrë
11 false pretendojnë që të jenë torturuar për shkaqe të ndryshme.
12 Të tjerë mund të ekzagjerojnë situatën, mund të ekzagjerojnë
13 një situatë relativisht të vogël për arsye politike ose
14 personale. Profesionistët gjithmonë duhet të kenë parasysh
15 këto mundësi dhe duhet që të mundohen që të identifikojnë
16 zmadhimet ose ekzagjerimet ose fabrikimet e mundshme."

17 Më poshtë pas disa fjalish thuhet që:

18 "Në qoftë se profesionisti dyshon se ka shpifje, atëherë
19 do të duhet që të bëhen intervista shtesë për të sqaruar
20 përpjethshmëritë në raport. Gjithashtu duhet të merret
21 parasysh edhe konfirmimi i familjarëve dhe miqve."

22 Pra, besoj që ju jeni të informuar me faktin që në
23 protokoll parashikon që ekziston mundësia e zmadhimit,
24 ekzagjerimit të simptomave ose të situatës, apo jo?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

Faqe 41

1 PY. Në protokoll gjithashtu parashikohen edhe hapa që do të
2 duhet të merren në qoftë se dyshohet se ka zmadhim ose
3 tjetërsim të fakteve, apo jo?

4 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

5 PY. Kur ka zmadhim, ekzagjerim dhe mos të thënies së vërtetës
6 mund të ekzistojë rreziku si i mbiraportimit ashtu edhe i
7 nënraportimit të simptomave, apo jo?

8 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

9 PY. Një mënyrë sesi profesionisti mund të vërtetojë ose mund
10 të identifikojë në qoftë se ka mbiraportim, domethënë, në
11 qoftë se raportohet më shumë ose zmadhohet situata ose në
12 qoftë se zvogëlohet ajo, është përmes kryerjes së intervistave
13 me anëtarë të tjerë të familjes, a është kështu, apo jo?

14 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Në qoftë se ka
15 arsye që dyshon, që ka zmadhim ose mostregim të së vërtetës,
16 atëherë kjo është një ndër mënyrat që parashikohen aty.

17 PY. Sa i takon raportit të prillit të 2025, ju nuk keni bërë
18 asnjë nga këto që unë përmenda pak më sipër në raportin e
19 2025?

20 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] E keni fjalën për
21 akt-ekspertizën tonë?

22 PY. Po, për raportin e prillit.

23 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, në fakt është e
24 vërtetë sepse ne nuk kemi marrë në intervistim, nuk kemi bërë
25 intervistim të veçantë të personave.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 42

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 Z. BAIESU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do t'ju
2 kërkoja që t'i caktonit një numër prove provizore kësaj faqeje
3 që sapo lexuam.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për cilën
5 faqe e keni fjalën?

6 Z. BAIESU: [Përkthim] Është faqja DJK01580.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 caktojini një numër prove provizore kësaj faqeje.

9 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e Gjykatës
10 këshillohen]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i shtojmë
12 në një dokument tjetër që ka një numër provizor prove po
13 ashtu.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të
15 nderuar Gjykatës. Është faqja me numër ERN DJK0580 e cila do
16 shtohet në dokumentin 1D00260, por do t'i shtojmë .1 në fund
17 në mënyrë të tillë që të identifikohet më mirë si provë
18 provizore për momentin.

19 Z. BAIESU: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit.
20 PY. Protokolli njeh mundësinë e ekzagjerimit ose zmadhimit të
21 simptomave të një personi për arsye politike dhe personale,
22 apo jo?

23 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

24 PY. Dhe një kërkesë për azil mund të jetë një prej arsyeve që
25 mund ta bëjë një person që ta ekzagjerojë ta zmadhojë ose të

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

Faqe 43

1 shpik simptoma, a është kështu?

2 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Është si mundësi,
3 mund të jetë një prej arsyeve.

4 PY. A jeni në dijeni të faktit që nga periudha 1989 deri në
5 1999, të paktën 350.000 shqiptarë etnikë janë larguar nga
6 Kosova dhe kanë aplikuar për azil në Evropën Perëndimore,
7 përfshirë edhe shqiptarët që kanë pretenduar se janë kosovarë.

8 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] A e thoni dhe një
9 herë nuk e kuptova se çfarë lidhje kishin shifrat me pyetjen?

10 PY. A jeni të informuar ose a jeni në dijeni të faktit se ka
11 pasur një numër shumë të madh shqiptarësh që janë larguar nga
12 Kosova?

13 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

14 PY. Duke marrë parasysh kontekstin, metodologjia e përdorur
15 prej jush a ka përfshirë hapa për të verifikuar në qoftë se
16 viktimat në këtë çështje gjyqësore kanë bërë kërkesa të
17 vazhdueshme për azil ose në qoftë se kanë ndonjë konstatim të
18 besueshëm sa i takon procesit të migracionit?

19 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Unë jam znj.

20 Prinsen. Për çfarë raporti e keni fjalën?

21 PY. Këtu e kam fjalën për akt-ekspertizën në veçanti,
22 metodologjinë që keni përdorur juve për të përgatitur akt-
23 ekspertizën tuaj. Dua të di se çfarë metodologjie keni
24 përdorur dhe në qoftë se ju keni përdorur apo jo historikun e
25 azilit të personave që keni vlerësuar si pjesë të raportit

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 44

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 tuaj?

2 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, nuk jemi marrë
3 fare me këtë, thjesht i kemi dhënë përgjigje pyetjeve që na
4 janë bërë.

5 PY. Por ju pajtoheni besoj me mua që Protokolli i Stambollit
6 përderisa është udhëzim, sikurse e thatë gjatë gjithë kohësh,
7 e ka këtë kërkesë që kur harton një raport një akt-ekspertizë
8 duhet që të shikohet mundësia e ekzagjerimit ose e zmadhimit,
9 apo jo?

10 Z. LAWS: [Përkthim] Do kundërshtoj mbi të njëjtën bazë.
11 Sepse dëshmitarët e thanë shpesh herë që Protokolli i
12 Stambollit nuk zbatohet për opinionet e ekspertëve, për
13 raportin e ekspertit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

15 Z. BAIESU: [Përkthim]

16 PY. Në fakt raporti juaj mbështetet vetëm në simptomat që
17 janë vetëraportuar në dëshmitë ligjore të dhëna nga persona të
18 caktuar dhe nuk është bërë një verifikim i pavarur i
19 viktimave, apo jo?

20 Znj. Prinsen, në qoftë se mund të na jepni një përgjigje?

21 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Mund ta thoni dhe
22 një herë pyetjen?

23 PY. Është një pyetje më e përgjithshme që prapë lidhet me
24 Protokollin e Stambollit, është e saktë të thuhet që raporti
25 mbështetet në simptomat që janë vetëraportuar në proceset

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

Faqe 45

1 gjyqësore të këtyre viktimave, ndërkohë që nuk është bërë një
2 verifikim i kontekstit më të gjerë të viktimave në fjalë, apo
3 jo?

4 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

5 PY. Dhe qasja që bën krahasimin e simptomave, të cilën ju e
6 shpjeguat dje dhe që ju thatë që ka literaturë mjekësore që i
7 referohet këtyre simptomave, nuk mund të bëjë dallimin
8 ndërmjet simptomave të vërteta dhe simptomave që zmadhohen ose
9 që shpiken nga mendja e dikujt, apo jo?

10 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, është e saktë.

11 Dhe besoj që do përsërisë veten kur të them se nuk është puna
12 jonë për të identifikuar se çfarë vlere t'i japim simptomave,
13 nuk është puna jonë që t'i japim vlerë juridike simptomave.

14 PY. Po pyetja ime ishte paksa ndryshe. Pyetja ime ishte në
15 qoftë se metodologjia që keni përdorur juve mund të bëjë
16 dallimin midis një traume të përgjithshme dhe simptomave që
17 janë të zmadhuara, të ekzagjeruara, të shpikura?

18 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Pra, në ekzaminimet
19 ligjore që ne kryejmë dhe, domethënë, ekzaminimet ligjore janë
20 të ndryshme nga raporti i ekspertit, nga akt-ekspertiza. Në
21 rastin e parë ne e bëjmë dhe mund ta bëjmë këtë gjë.

22 Megjithatë, është e rëndësishme që në paragrafin 348 duhet
23 lexuar dhe kjo fjalia që ju nuk e lexuat, thuhet që:

24 "Profesionisti duhet të mbajë parasysh që fabrikimi i
25 tillë ose shpikja e tillë duhet që të marrin parasysh edhe

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

Faqe 46

1 informacione të cilat viktima shpeshherë nuk i ka.”

2 Kështu që, unë nuk mund ta di dot në qoftë se personi e
3 ka zmadhuar, e ka sajuar me mendjen e vet sepse nuk kemi bërë
4 ekzaminim mjekësor. Për këtë akt-ekspertizë në fjalë nuk mund
5 të them gjë tjetër lidhur me këtë pyetje.

6 PY. Pjesa e paragrafit 348 që ua lexova ka një titull në
7 raport, që është pika 18, “Ndryshueshmëria dhe
8 papërputhshmëria në historik”. Nuk është një pjesë e raportit
9 që ka të bëjë me ekzaminim mjekësor.

10 Megjithatë pyetja e fundit që kam për ju është kjo: A do
11 ishte e drejtë të thuhej se një prej vështirësive që haset në
12 hartimin e një raporti të tillë është mungesa e aftësisë për
13 të identifikuar në qoftë se simptomat zmadhohen për përfitime
14 dytësore që mund të jenë të llojit, për shembull, që dikush
15 është i interesuar të bëjë një kërkesë për azil.

16 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Catherine Black. Mendoj,
17 përsëri, se mbase e përsëritëm disa herë, por kjo është diçka
18 që shkon përtej fushëveprimit të këtij raporti. Nuk e bëjmë
19 dot këtë vlerësim ne. Ju iu referuat Protokollit të Stambollit
20 dhe jua kemi shpjeguar disa herë, në fakt, që Protokolli i
21 Stambollit është një udhëzim për ekzaminimet mjekësore,
22 ndërkohë që raporti i prillit të 2025-s nuk është një raport i
23 tillë, pra, që kërkohet prej Protokollit të Stambollit. Në
24 raport, në akt-ekspertizën tonë ne jemi të qartë, por ndërkohë
25 që fabrikimi ose shpikja e simptomave, sikurse e tha kolegja

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)

Faqe 47

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 ime, është diçka që duhet ta mbajnë parasysh profesionistët,
2 megjithatë kërkon njohuri të hollësishme për simptomat që
3 lidhen me traumat që individët zakonisht nuk i kanë, kështu që
4 nga përvoja jonë me traumën dhe nga vetë fakti që Kombet e
5 Bashkuara kanë vendosur që të nxjerrin këtë Protokoll të
6 Stambollit, ne nga përvoja jonë e dimë që në përgjithësi është
7 e vështirë që të nxirren simptomat nga viktimat e torturës dhe
8 se kërkohet një protokoll për specialistët e të gjitha
9 disiplinave, përfshirë këtu, për shembull, në disiplinat
10 mjekësore, psikologjike, ligjore, në mënyrë të tillë që ta
11 kemi të gjithë në tryezë këtë dokument.

12 Pra, fakti që është e nevojshme që të kemi një dokument
13 të tillë, pra, fakti që është identifikuar që duhet bërë një
14 instrument, që duhej të botohej Protokolli i Stambollit, në
15 vetvete pranon rëndësinë e madhe të faktit që duhet të kishte
16 një udhëzues të kësaj natyre.

17 PY. Por protokolli dhe, në fakt, këtë e kam kuptuar nga
18 dëshmia e znj. Prinsen dhe, protokolli është udhëzues jo vetëm
19 për ekzaminimet mjekësore, por është edhe një udhëzues sesi të
20 kryhen ekzaminime, si të identifikohen simptomat e viktimave
21 të torturës dhe si të bëhen konstatimet, përfundimet.

22 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Neve në raportin tonë kemi
23 thënë që këto janë simptomat e përgjithshme të literaturës,
24 jemi referuar gjithashtu edhe pjesëve më të rëndësishme të
25 Protokollit të Stambollit dhe gjithashtu me të dhënat që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë private)

Faqe 48

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje të palës tjetër nga z. Baiesu

1 kishim në dispozicion, sigurisht edhe me kufizimet që kemi
2 diskutuar, kemi përshkruar që këto janë simptomat e
3 raportuara. Opinioni ynë prej ekspertesh është që përderisa
4 mjedisi, ambienti ku janë raportuar këto simptoma nuk është
5 projektuar që të merren këto simptoma dhe përderisa neve si
6 profesioniste e dimë që është shumë e vështirë që persona të
7 raportojnë simptoma, ne mendojmë që ka më shumë gjasa që të
8 kemi të bëjmë me një nënpërfaqësim ose nënraportim të
9 simptomave ose, e thënë me fjalë të tjera, që simptomat e
10 thëna nga viktimat janë shumë më pak sesa ato që janë në
11 realitet.

12 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje tjera për ju.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 z. Baiesu.

15 Z. Laws, keni pyetje plotësuese?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Po, kam disa pyetje plotësuese në
17 qoftë se do më lejoni.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

19 Z. LAWS: [Përkthim] Në rregull. Për pyetjen e parë do dua
20 që të kalojmë në seancë private.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
22 Sekretare, na kaloni në seancë private.

23 [Seancë private]

24 [Seancë private teksti i fshirë]

25

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë private)

Faqe 49

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje vijuese nga Mbrojtësi i Viktimave

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë private)

Faqe 50

Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)

Pyetje vijuese nga Mbrojtësi i Viktimave

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

20 Z. LAWS: [Përkthim]

21 PY. Znj. Prinsen, sot u pyetët lidhur me mundësinë e gabimeve
22 në përkthime, në faqen 11, 12 të transkriptit të sotëm gjendet
23 kjo pyetje.

24 A mund t'ju pyes, a i keni lexuar tre raportet në këtë

25 çështje?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje vijuese nga Mbrojtësi i Viktimave

Faqe 51

1 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

2 PY. A i keni identifikuar gabimet që i keni parë kur i keni
3 lexuar këto raporte?

4 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

5 PY. Faleminderit. Juve u pyetët për kontributet e dhëna nga
6 të tjerët dhe do t'i marr një nga një. Kolegu juaaj Jet Steen,
7 ju u pyetët lidhur me këtë në faqen 19 të transkriptit të
8 sotëm provizor. Na thatë, na treguat për kontributin e saj. A
9 ka diçka në raport që në të cilën ajo ka kontribuar me të
10 cilën ju nuk pajtoheni?

11 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo.

12 PY. U pyetët gjithashtu për kontributin e dhënë nga kolegu
13 juaaj Dr. Parra në faqen 24 të transkriptit të sotëm. A ka
14 ndonjë gjë nga kontributi që ka dhënë ajo me të cilën ju nuk
15 pajtoheni në raport?

16 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, siç e thashë më
17 herët, nuk do ta kishim dorëzuar këtë raport po të kishim pas
18 mospërputhje, mosdakordsi.

19 PY. A ju janë bërë këto pyetje në këtë sallë gjyqi nga kushdo
20 apo në procedura të tjera ligjore, proceset e tjera për të
21 cilat ju jeni ndjerë, znj. Prinsen, që nuk ishit kompetente
22 për t'u përgjigjur apo për të cilat patët nevojë të
23 konsultoheshit me Dr. Parra lidhur me këtë pra? A ka patur
24 ndonjë pyetje të kësaj natyre?

25 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, ky është raport

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 52

1 i përbashkët, është ekzaminim i bërë së bashku.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Gjykatësi Gaynor.

5 Pyetje nga Trupi Gjykses:

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pyetja e parë për ju znj.

7 Prinsen, ka të bëjë me dy raportet të vitit 2023 dhe 2022. Në
8 secilin prej këtyre raporteve ju thoni, mendoj, në pjesën
9 hyrëse që: iMMO respekton udhëzimet e Protokollit të
10 Stambollit.

11 A e kuptoj saktë që ju keni përgatitur këto raporte në
12 përputhje me këto udhëzime?

13 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po, i kemi bërë në
14 përputhje me këto udhëzime.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, të dy raportet i 2022
16 dhe i 2023 janë përpiluar në përputhje me këto udhëzime?

17 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Po.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani në poshtëshënimin 1 në
19 raportin e vitit 2023 ju citoni në versionin e vitit 2022 të
20 udhëzimeve në poshtëshënimin 1 të raportit të mëparshëm ju
21 përmendni versionin e vitit 1999 të këtyre udhëzimeve,
22 dokument që mendoj që është shumë më i shkurtër.

23 Pyetja ime e vetme lidhur me këtë: A ka ndonjë dallim në
24 qasjen që keni patur ju për dy raportet, ai që bazohet në
25 udhëzimet e vitit 1999 dhe ai që bazohet në udhëzimet e vitit

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 53

1 2022?

2 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Jo, nuk ka. Është
3 kusht i ri i raportit që është më i gjatë, por nuk ka ndryshim
4 në udhëzimet në mënyrën sesi duhet të zhbëhet ekzaminimi
5 mjeko-ligjor.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

7 Kam vetëm dy pyetje të shkurtra në lidhje me raportin e
8 vitit 2025, secila prej jush mund të përgjigjet. Analiza
9 statistike në pjesën e parë të raportit, nëse e kuptoj saktë,
10 është e përgjithshme, e natyrës së përgjithshme. Desha t'ju
11 jap dy shembuj juve.

12 Në faqen 4 thotë --

13 Dhe kjo pyetje u bë dhe nga Mbrojtësi i z. Veseli.

14 "Në Kosovë rreth 65 për qind e popullsisë kanë përjetuar
15 ngjarje traumatike gjatë luftës që kanë çuar në rreth 200.000-
16 400.000 individë të traumatizuar."

17 Në këtë fjali, a e kuptoj saktë, që kjo traumë mund të
18 jetë shkaktuar nga cilado palë që merr pjesë në konflikt?

19 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Burimet nuk saktësohen aty.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, kur paraqisni këto
21 elementë të analizës statistike, ata nuk varen në asnjë mënyrë
22 në identitetin e palës pjesëmarrëse në konflikt që mund të
23 ketë shkaktuar traumën në një mënyrë apo në një tjetër?

24 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Pjesa e parë e raportit
25 është një shqyrtim, rishikim i literaturës. Nuk është analizë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 54

1 statistike që kemi bërë ne.

2 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po.

3 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Dhe referenca është
4 referencë në literaturën, pra, numër specifik, pra, numri --
5 këtë shifër pra, 84 për qind. Keni dhe referencën për
6 artikullin shkencor të plotë në të cilin mund të gjeni
7 analizën statistike në literaturën që ata -- në analizën
8 statistike që kanë bërë ata. Pra, do të më duhet të shoh
9 referencën e plotë, ky është studim përshkrues. Nuk është --
10 është përshkrues dhe vëzhgues, studim përshkrues dhe vëzhgues.
11 Ata përshkruajnë një numër, pra, një shifër përqindje të
12 viktimave me PTSD që kanë konstatuar.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për shembull, në faqen 7,
14 thotë, duke u referuar një raportit tjetër:

15 "... 17.1 për qind e shqiptarëve të Kosovës shfaqnin
16 simptoma PTSD."

17 Dhe ju nuk po thoni fare, nuk po sugjeroni se cila palë
18 pjesëmarrëse në konflikt mund të ketë qenë në një mënyrë apo
19 në një tjetër shkaku i këtyre simptomave, apo jo?

20 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Jo.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në pjesën e dytë, në fakt,
22 mund të qëndroj në pjesën e parë të raportit në faqen 13, ju
23 thoni:

24 "Një studim i zhvilluar dhjetë vjetë pas luftës në Kosovë
25 zbulon se të mbeturit e ve apo vejushë për shkak të luftës i

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 55

1 kombinuar me nënat me simptoma depresive të nënave pa
2 bashkëshortë, simptomat PTSD dhe simptomat e ankthit.”

3 Ju i referoheni një raporti të përgatitur nga Morina dhe
4 Emmelkamp. Ndoshta dy raportet nga ajo. A dini ju pa shikuar
5 burimin, pra, materialin burimor, a ishte ky studim, a është
6 bërë ky studim për të vejat, gratë e veja apo nënat e ngelura
7 pa bashkëshort nëse kjo është shkaktuar, pra, kjo ndonjëra
8 prej palëve që mori pjesë në konflikt?

9 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Nuk mund t’i përgjigjem
10 kësaj pa referencën konkrete, specifike. Ndoshta Karin mund ta
11 bëj, mund të japë këtë përgjigje. Duhet ta shikojë atë. Mendoj
12 që ka pak gjasa që ata të kenë përshkruar në raport këtë gjë,
13 por kjo është literaturë mjekësore.

14 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull.

15 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Ka pak gjasa, por është e
16 mundur varet edhe nga kampionet që janë zgjedhur për të bërë
17 secilin prej studimeve.

18 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Në pjesën e dytë
19 të raportit ku ju mbështeteni në informacionet që i janë dhënë
20 iMMO-s nga VPP-të përmes Mbrojtësi i Viktimave keni dhënë një
21 numër të caktuar të deklaratash, konstatimesh, dua që të jetë
22 e qartë për procesverbal, tërësisht e qartë lidhur me këtë, ju
23 thoni, për shembull, në faqen 20:

24 “Shumë viktima, ku në veçanti viktimat jo të
25 drejtpërdrejta, raportojnë ndikimin negativ në familjet e tyre

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Pyetje nga Trupi Gjykues

Faqe 56

1 dhe konstatojnë efektet negative të mospasjes së drejtësisë
2 dhe mbylljes së këtij procesi.”

3 Tani, po flasim -- kur po flisnit për viktimat aty, a po
4 i referoheshit në mënyrë ekskluzive viktimave, materialit të
5 cilave ju është dhënë ju nga Mbrojtësi i Viktimave, apo jo?

6 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] E saktë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, pjesa e dytë e raportit
8 -- në pjesën e dytë të raportit të gjitha pohimet apo
9 konstatimet kishin të bëjnë ekskluzivisht me atë, ishin të
10 bazuara kryesisht ekskluzivisht në atë material.

11 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Është e saktë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nuk kam pyetje tjera.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 Gjykatësi Gaynor.

15 Ndonjë pyetje, z. Laws?

16 Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam pyetje.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga ZPS-ja
18 ndonjë pyetje tjetër?

19 ZNJ. CLANTON: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pustay? Z.
21 Dixon?

22 Z. DIXON: [Përkthim] Nuk kemi pyetje.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkoj
24 ndjesë, znj. Sheremeti? Z. Baiesu, pyetje tjera?

25 Z. BAIESU: [Përkthim] Nuk kemi pyetje tjera.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitarja: Karin Duhne-Prinsen (Vijon) (Seancë e hapur)
Dëshmitarja: Catherine Nicola Black (Vijon)
Çështje procedurale

Faqe 57

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Kemi përfunduar dëshminë tuaj. Jam i sigurtë që edhe ju
3 jeni të kënaqur të dëgjoni këtë gjë. Dhe ju falënderojmë për
4 praninë tuaj dhe dëshminë tuaj dhe ndarjen e informacionit që
5 keni bërë me ne.

6 Tani mund të largoheni, znj. Prinsen dhe Dr. Black dhe
7 një herë faleminderit për praninë tuaj.

8 DËSHMITARJA DUHNE-PRINSEN: [Përkthim] Faleminderit, të
9 nderuar.

10 DËSHMITARJA BLACK: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar.

11 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

12 [Dëshmitaret largohen]

13 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar, kam një referencë tani
14 që kur kërkoja që të shfaqet dokumenti, dokumenti i plotë
15 është që është tani MFI është DKV1755 deri 1775. Ky është
16 kapitulli i plotë i burimit në fund i renditur.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. DIXON: [Përkthim] Megjëse jam në këmbë dhe po flas
19 lidhur me programin, kalendarin apo afatet për paraqitjen e
20 parashtrimeve lidhur me këto raporte --

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
22 parashtrime gojore sot. I kemi parë kundërshtimet e mëparshëm
23 të paraqitura me shkrim, kemi dëgjuar ato në fillim, përpara
24 se të fillojmë, besoj se janë të plota dhe të tërësishme. Nëse
25 dëshirojmë të bëjmë një parashtrim, do të bëjmë një pushim të

1 shkurtër dhe të kthehemi për të bërë parashtrimin.

2 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar, ajo që do të kërkoja
3 nëse më lejohet, duke qenë se z. Laws paraqiti raportet për
4 t'u pranuar si prova, ne jemi përgjegjgur fillimisht lidhur me
5 këtë, kemi kërkuar që të na jepet një kohë e shkurtër, ndoshta
6 disa ditë që të plotësojmë parashtrimet tona me shkrim në
7 mënyrë që të shqyrtojmë dhe të ekzaminojmë transkriptin dhe të
8 kemi kohë që ta bëjmë këtë në një përgjigje të shkurtër nga z.
9 Laws nëse dëshiron. Por mund të bëhet në mënyrë shumë të
10 shkurtër dhe koncize në mënyrë që të jemi në kohë për ta bërë
11 atë dhe që të mos humbasim asgjë gjatë këtij procesi. Do të
12 kërkoja lejen tuaj lidhur me këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws, a
14 dëshironi të thoni diçka lidhur me këtë?

15 Z. LAWS: [Përkthim] Ne mbështesim këtë kërkesë. Është
16 temë e detajuar në hollësi. Raporti mbulon, përfshin shumë
17 faqe dhe do jetë e vështirë ndoshta që të përqendrohemi në
18 secilin prej këtyre hollësive që mund të paraqesë Mbrojtja në
19 parashtrimet e tyre. Qëndrimi jonë është që do të ishte më
20 mirë që të bëhet me shkrim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe a do të
22 përfshini me shkrim cilin prej këtyre dokumenteve me numër
23 provizor duhet të pranohen?

24 Z. LAWS: [Përkthim] Ne do të përfshijmë në parashtrimet
25 tona me shkrim materialet që ne dëshirojmë të pranohen,

1 kërkojmë që të pranohen dhe kjo do t'i përfshijë të gjitha
2 materialet që kemi kërkuar, për të cilat kemi kërkuar të
3 caktohet një numër provizor. Por do të kundërshtojmë të paktën
4 një prej dokumenteve të propozuar nga Mbrojtja.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dy gjëra, z.
8 Dixon. Ju përdorët vetëm një faqe të atij dokumenti. Pse duhet
9 që ta pranojmë të tërin? Pse mos të vejme vetëm këtë faqe?

10 Z. DIXON: [Përkthim] Po. Në fakt ishte thjesht për të
11 siguruar që pjesa të cilën e lexova, që ishte një përmbledhje,
12 që shpjegohet pastaj, shpjegohet më tej, të merret parasysh në
13 mënyrë që kjo përmbledhje që përpiqet të përfshijë gjithçka,
14 të jetë më e gjerë dhe të shqyrtohet nëse është e nevojshme
15 apo të shikohet. Por pika kryesore është përmbledhja sepse
16 ishte ajo mbi këtë bazë që u bënë pyetjet eksperteve dhe ato
17 dhanë komentet e tyre.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Do t'ju japim kohë deri të hënën të gjithëve për të
20 parashtruar kundërshtimet tuaja. Dhe mendoj që do kenë një
21 pozicion të përbashkët, një qëndrim të përbashkët lidhur me
22 këto.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm një
25 dokument.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe
3 kundërpërgjigja të enjten. Edhe një herë shqyrtoheni,
4 rishikoheni dhe një herë që të sigurohemi se nuk na duhen të
5 30 faqet e materialit. Në qoftë se do të kemi nevojë për një
6 faqe plus dhe përmbledhjen, ndoshta janë dy faqe këto i bie.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'ju
9 japim një emër atyre dhe t'i pranojmë.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe do të
12 marrim parasysh pranimin e tyre.

13 Z. DIXON: [Përkthim] T'i mbajmë në numër sa më të
14 kufizuar që është e mundur. Dhe gjithashtu parashtimet tua
15 duhen të përqendrohen në atë që doli nga dëshmia që të mos
16 shtojmë ato që ekziston tashmë, nuk duhet të jenë parashtime
17 të gjata.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,
19 kundërpërgjigja juaj të hënën dhe kundërpërgjigja nga z. Laws
20 të enjten.

21 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, besoj që
24 kemi përfunduar për sot. A ka diçka tjetër?

25 Z. LAWS: [Përkthim] Mund të ngre një çështje të shkurtër,

1 ju lutem?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

3 Z. LAWS: [Përkthim] Pas vendimit të hënën për faktet e
4 gjykuara në shqyrtimet e tjera për pranim, ishte parashikuar
5 që të behej, por ne nuk ishim në gjendje që ta bënim deri në
6 pritje të vendimit që do të merrej nga Paneli i Apelit. Tani
7 ky vendim është marrë, Gjykata mund të marrë njoftimin lidhur
8 me faktet e gjykuara, e shqyrtuara në procese të tjera nga ai
9 vendim. Mund të na jepet deri tek i njëjti afat kohor, deri të
10 enjten edhe neve që të parashtrojmë mocionin tonë?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
12 çaktivizuar].

13 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta
15 dëshironi që t'i kundërpërgjigjeni dhe këtij parashtrimi
16 shtesë.

17 Z. DIXON: [Përkthim] Të nderuar, në fakt edhe ne duam
18 kështu, sepse kjo është çështje që është ngritur.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, do jetë
20 afati të enjten, pra, do të jetë nga Viti i Ri, të enjten, të
21 premtën, të shtunën dhe të hënën në vijim.

22 Z. DIXON: [Përkthim] Po, do ta bëjmë këtë gjë.
23 Faleminderit. Dhe sapo më thanë se nuk keni aktgjykimin
24 konfidencial akoma. Po kërkojmë leje që ta kemi sot dhe do ta
25 marrim atë në mënyrë që të jemi në gjendje ta rishikojmë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jam i sigurtë
2 që do ta keni atë në kohë.

3 Z. DIXON: [Përkthim] Po.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të vijë
5 ky material në qoftë se keni problemi na thoni neve.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull. Do t'ju kontaktojmë nëse
7 kemi nevojë, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse ka diçka
9 tjetër nga dikush tjetër? Ju shoh, ritakohemi këtu të martën
10 atëherë për Konferencë mbi Ecurinë e Çështjes, që të
11 sigurohemi që gjithçka është gati për konferencën përgatitore
12 të Mbrojtjes që do të mbahet pas pushimit të verës.

13 Faleminderit për praninë tuaj sot dhe shihemi të martën.

14 --- Seanca mbyllet në orën 10.46

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25